AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Nr. 3508 Prot.
Datë më 08.10.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
**AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE**
**SHKOLLA E MESME PROFESIONALE**
**TREGTARE VLORË**

**Nr. 60 Prot**

**Vlorë , më 07.10.2021**

**Lënda:** Njoftim për vend të lirë pune

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 14 datë, 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", Ofruesi publik i AFP-së Shkolla Tregtare Vlorë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicione pune :

**Pozicioni 1:**

**DEGA - HOTELERI TURIZËM PËR PERSONELIN MËSIMËDHËNËS TË TEORISË PROFESIONALE (me kohë të plot )**

**Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme.**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lire si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë përtë vepruar

b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale

d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar

Lagjia "Uje Ftohte Vlore " e-mail: tregtareshkolla@yahoo.com

e) të demostrojë vlera të larta të etikës ,sjeljes dhe komunikimit

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së si vijon:**

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme në të njëtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së ,për të cilin /cilat po aplikon .

b) të ketë të paktën 1 (një) vjit përvojë pune në fushën,në të cilën ka kryer studimet.

c) të njohë dhe të përdorë teknologjin e informacionit.

**Dokumentet e aplikimit Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë: -**

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në);

c) kartën e identitetit;

d) diplomën;

e) librezën e punës;

f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g)- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) - vërtetimin e gjendjes shëndetësore;

i) - vërtetimin e gjendjes gjyqësore;

j) - vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

3.Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës ..28.10.2021.

DREJTORE

SHPRESA SALIAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE · SHKOLLA E MESME TREGTARE · VLORE

Lagjia "Uje Ftohte Vlore" e-mail: tregtareshkolla@yahoo.com